

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fjalimi i plotë nga kryeministri Edi Rama në OKB
ADRESA	https://kohajone.com/forum/fjalimi-i-plote-nga-kryeministri-edi-rama-ne-okb/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 18:52:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 18:49:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	585ab8e52c2973b61383b8c23eed4d842f3fe0493aa61edf951348298856b301
TEKSTI	13ee55a11cde9044f6608b37a732da04ff4588b0cbd9b6f9067501a174a6811a
PAMJA	0c712889f4e726f382abb1203de8ddf3f805af1aa3856d160785ba9b7749c962

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7438155e44583ba9208341b6cdcdb20f1c8d094e06294a701ca57d0841154a8f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9fd2d6c8eaed582dbfbd973ad421bf483fa1abd0a548cdf1a11aa95128494a7b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/7438155e44583ba9208341b6cdcdb20f1c8d094e06294a701ca57d0841154a8f

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fjalimi i plotë nga kryeministri Edi Rama në OKB

FORUM LAJME E PREMTE, 25 SHTATOR 2026 20:49



Nga Edi Rama

Duket se është radha ime për të predikuar në këtë shkretëtirë ku mbliidhemi çdo vit e kjo radhë erdhi dhe e marr këtë si privilegj i të paktëve. Zoti president, të dashur përfaqësues të popujve të Kombeve të Bashkuara, Jam surprizuar shumë pozitivisht që shumë miq donin të dinin rreth asaj çfarë po ndodh në vendin tonë me inteligjencën artificiale dhe mendova që ishte një ide e mirë të ndaja me ju mendimet për këtë. Baruti ndryshoi fushëbetëjen. Fisioni bërthamor ndryshoi kuptimin e mbijetesës njerëzore. Inteligjenca artificiale po ndryshon diçka edhe më intime. Kush mund të hyjë në mendjen e një qytetari, të imitojë një zë të besuar, të prodhojë një realitet të kalibruar mbi frikërat e një personi e ta bëjë këtë miliona herë në të njëjtën kohë?



Shqipëria nuk është zhvilluese e modeleve të fjalës së fundit, por jemi një komb që e kemi jetuar tashmë të ardhmen që të tjerë ende janë duke e debatuar. Mendoj që mesazhi që ju detyrohem është një mesazh tejte i thjeshtë. Rreziku i menjëhershëm e më i madh nuk është se inteligjenca artificiale do të ndalet së binduri njerëzimit. Rreziku më i madh do të jetë që do t'i bindet në mënyrë të përkryer individit të gabuar. Slida vjen në tre nivele, në tre shtresa. Çfarë na bën, çfarë bën inteligjenca artificiale në vendin tonë? Çfarë na bën ne dhe kush e përfton fuqinë për të mbërritur tek ne. Së pari, çfarë bën në vendin tonë?



Në fakt, debati publik përfytyron makina që zgjohen, kanë ambicie dhe kthehen kundër krijuesve të tyre, por sistemet me të cilat përballemi sot nuk zgjohen me urrejtje në zemrën e tyre. Shumëfishojnë tonën. Ato nuk kanë ambicie të vetën, por u shërbejnë ambicioneve të të tjerëve. Nuk mbajnë flamuj, por mund të dislokohen nga një shtet. Nuk thonë gënjeshtër për interes të tyre, por mund të thonë miliarda gënjeshtër për llogaritë e të tjerëve. Makina nuk ka ndërgjegje, por mund të huazojë shtrirjen e një qeverie, precizionin e një arme dhe intimitetin e një miku. E në të njëjtën kohë, stimujt ekonomikë që rrethojnë inteligjencën artificiale shpërblejnë gjithmonë e më tepër zëvendësimin e përpjekjes njerëzore në vend të zgjerimit e rritjes së kapacitetit njerëzor.

"Shkruaje kodin që të mos më duhet ta kuptoj".

"Hartoje raportin që të mos mendoj përgjatë tij".

"Po bëj një gjykim, merr një vendim në mënyrë që të mos mbaj përgjegjësi për këtë".

LAJMET KRYESORE



Rama në OKB: Protesta në Tiranë u ngrit mbi "fantazmën" e pushtimit izraelit. Duhet një marrëveshje ndërkombëtare për IA



Rama nga New Yorku: Nuk më ndalin me baltë dhe jargë, Shqipërinë do ta çoj në majën e Europës së Bashkuar



Rama në New York: Joe Biden e tradhtoi Hashim Thaçin, Amerika nuk bëri më të mirën



Ambasadori Eric Wendt mbërrin në Tiranë, nis kapitulli i ri i diplomacisë amerikane



Zgjedhjet lokale në 2027, KQZ kërkon rreth 300 punonjës shtesë

TË PËRZGJEDHURA



David Beckham merr 39 milionë paund dividend, marrëveshjet e Kupës së Botës nxisin fitime rekord



Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hijet Balluku-lokomotivë shtetfo...



Sukses i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude



Inteligjenca artificiale mund të jetë më e rrezikshme se bomba atomike. Robotët e vitëve 2030, 2040, 2...



Hamilton mohon kategorikisht: "S'kam kërkuar ndryshime stafi te Ferrari"

MË TË LEXUARAT

Kur sukcesi matet vetëm me sa shumë punë i heq makina qenies njerëzore, mund të krijojme institucione më efikase, por do të kemi njerëz më pak të aftë. Një civilizim që e përjashton përpjekjen në vijim mund t'ua jashtëkontraktojë dijen. Një civilizim që jua lë në dorë dijen të tjerëve mund në vijim të lërë në dorë gjykimin e një civilizimi që lë në dorë jashtë gjykimin, mund të zbulojë që në fakt ka lënë në dorë të të jashtëmëve përgjegjësinë dhe në fakt nuk është e pashmangshme, është zgjedhje.

Ne mund të ndërtojmë një inteligjencë artificiale që mëson, në vend që thjesht të përgjigjet, që orientojnë, në vend që thjesht të komandojë e që fuqizon qenien njerëzore në vend që qenia njerëzore të bëhet e varur prej saj. Pyetja nuk shtrohet se sa shpejt e kreu punën makina. Duhet të shtrojmë pyetjen: çfarë mësoi qenia njerëzore? Kush e kuptoi vendimin? Kush mund ta kundërshtojë këtë vendim dhe kush përgjigjet për vendimin kur është i gabuar? Shqipëria u bë vendi i parë që solli një instrument të inteligjencës artificiale në arkitekturën e qeverisë përmes Diellës, ministria jonë e njohur botërisht e inteligjencës artificiale dhe nuk e bëmë këtë për të transferuar sovranitetin nga njerëzit te makina. E bëmë për t'i bërë shërbimet publike më të aksesueshme, procedurat më transparente dhe shtetin më llogaridhënës.

Asnjë makinë nuk mbart legjitimitet demokratik e asnjë algoritëm nuk trashëgon përgjegjësi kushtetuese. Pas çdo vendimi me ndikim publik duhet të mbetet një mandat ligjor, një institucion njerëzor e një emër që mund të thirret për t'u përgjigjur. Shtresa e dytë është ajo çfarë mund të na bëjë inteligjenca artificiale. Inteligjenca artificiale brenda një vendi e shteti llogaridhënës mund të reduktojë distancën midis qytetarëve dhe shërbimeve publike. Ndërkohë që inteligjenca artificiale jashtë llogaridhënies mund të eliminojë distancën midis gënjeshtres dhe mendjes njerëzore. Shqipëria e ka përjetuar drejtpërdrejt një gjë të tillë dhe jam i sigurt që ju i keni ndjekur ose thjesht keni mësuar për të ashtuqajturin revolucion të flamingove.

Narrativa e trilluar e një pushtimi izraelit në bregdetit shqiptar. Një pushtim që kurrë nuk ndodhi. U fabrikua, u personalizua e u përcoll përmes zërave, faqeve e kanaleve të cilave qytetarët u besonin tashmë. Një qytetar mori një histori të një traditë kombëtare, tjetri dëgjoi një histori të një provokimi fetar, ndërsa tjetri përftoi konspiracionin e një pushtimi të huaj. Trillime të ndryshme hyjnë në botë të ndryshme emocionale, të gjitha në shërbim të së njëjtës gënjeshtre strategjike. Pasojat ishin reale. Qytetarët kishin arsytet e tyre për të protestuar, mos më keqkuptoni, por befasi nisën të protestonin edhe kundër një armiku fantazmë.

Shprehja antisemite hyn në ligjërimin tonë publik për herë të parë ndonjëherë. Mos harroni, Shqipëria është i vetmi vend në Europë që e mbylli Luftën e Dytë Botërore me më shumë hebrenj sesa në fillim të saj. Frika u shndërrua në zemëratë. Zemëratat u shndërruan në mobilizim dhe trillimi u shndërrua në realitet politik dhe nuk ishte një eksperiment laboratorik. Nuk po ju flas për filma fantastiko-shkencorë. Ishte thjesht një e martë në Tiranë, kryeqytetin tonë. Algoritmi nuk shpiku objektivin. Qe një aktor njerëzor që e bëri këtë. Algoritmi nuk e zhvilloi, nuk e ndezi urrejtjen, por zbuloi si ta aktivizonte urrejtjen tonë. Ky është mashtrim sistematik si shërbim. Ndërhyrjet në zgjedhje nuk kërkojnë më thjesht një stacion televiziv apo një copëz propagande që i përsëritet të gjithë popullatës. Tashmë mund të veprojmë me vendosmërinë e secilit prej votuesve. Dy fajn mund të jetojnë në të njëjtën rrugë, të votojnë në të njëjtat palë zgjedhesh dhe të jetojnë brenda realiteteve kryekëput të ndryshme, secili prej të cilëve është prodhuar specifikisht për secilin prej tyre.

Kur kjo ndodh, demokracia nuk humbet thjesht një debat apo thjesht një radhë zgjedhesh, humbet terrenin e përbashkët mbi të cilin bëhet i mundur debati dhe humb edhe mundësinë për ta pasur atë. Sovraniteti nuk gërryhet më në kufi, gërryhet nëpër "feed-e". Në shekullin e XX-të sovraniteti kuptonte kontrollin për tokën, ujërat territoriale dhe hapësirën kombëtare ajrore. Sot në Europë ne po vrapojmë si të marrë për të shtuar gjithmonë e më shumë, për të hedhur gjithmonë e më shumë para që nuk i kemi për të mbrojtur tokat tona, për të mbrojtur qiejt tanë nga një luftë e mundshme në të ardhmen, por disi po harrojmë që në shekullin që jetojmë, duhet që kjo të nënkuptojë edhe aftësinë e një shoqërie të lirë për të mbrojtur kushtet në të cilat qytetarët e saj formojnë opinionin e vet. Pa këtë aftësi, sovraniteti mbi tokën, mbi qiejt bëhet thjesht një iluzion e pastaj vjen shtresa e tretë: shpërndarja.

Për shekuj të tërë kërcënimin më i madh ndaj lirisë së fjalës ishte censura. Sot, liria e fjalës kërcënohet po kështu nga përdorimi si armë i lirisë së shpërndarjes. Fjala është e drejta për të shprehur një ide, shpërndarja është fuqia për ta vënë këtë ide përpara miliona njerëzve. Fjala i përket qenies njerëzore. Shpërndarja mund të blihet, automatizohet, të manipulohet dhe të caktohet fshehtësisht, të vendoset fshehtësisht nga platformat, korporatat, rrjetet kriminale dhe shtetet e huaja. E drejta për të folur është universale, por nuk ka një të drejtë universale për shpërndarjen anonime të pakufizuar dhe të amplifikuar artificialisht. Kur një gënjeshtër shumëfishohet miliarda herë, e vërteta nuk ka nevojë më të censurohet, sepse thjesht varroset. Qytetari mbetet formalisht i lirë të flasë, por flet në një stuhë që asnjë zë njerëzor nuk mund ta përballojë.

Liria e fjalës, për rrjedhojë, mund të pësojë disfatë pa ndaluar asnjë libër të vetëm, pa burgosur asnjë gazetar të vetëm e pa fshirë as dhe një të vetmin postim.

Përgjigjja për fjalën e për të folurin e keq mbetet më shumë liri fjale, por përgjigjja për amplifikimin e fshehtë e industrial duhet të jetë ekspozim e duhet të bëhet më herët sesa vonë. Kush e krijoi mesazhin, kush pagoi për të? U shpërnda nga njerëzit apo nga makinat? Pse u shënjestrua qytetari? A ishte reagimi i dukshëm publik origjinal i koordinuar apo i drejtuar nga jashtë? Të mbrosh demokracinë e të mbrosh një mënyrë jetese e lirinë e secilit komb për të jetuar në mënyrën e vet, nuk do të thotë të kontrollosh se çfarë lejohet njerëzit të mendojnë. Nënkupton të shpërfaqësh fuqitë e fshehura që kërkojnë të kontrollojnë atë që njerëzit detyrohen të shohin. Nëqoftëse ne mbrojmë lirinë e shprehjes duke e lënë kontrollin e shpërndarjes krejt në terr, atëherë është njësoj si të mbrosh derën po të dorëzosh të gjithë dhomën.

Disa përgjigjen duke kërkuar që inteligjenca artificiale të ndalet apo të ngadalësohet. Ne jemi shumë të vegjël, por më shumë respekt nuk do të biem dakord. Një pauzë nga demokracitë nuk do të sjellë pauzë nga diktaturat. Një moratorium i respektuar nga shtete të përgjegjshme nuk do të kufizojë fuqitë armiqësore, rrjetet ndërkombëtare kriminale apo industritë e manipulimit. Ne nuk mund të rregullojmë veten tonë deri në pafuqi. Për këtë pyetje thelbësore strategjike,

presidenti i SHBA-se ka te drejte, nuk duhet te ndalemi, duhet te pershpertojme, por pershpertimi duhet te kete nje drejtim. Na duhet nje inteligjencë artificiale që është e verifikueshme, transparente dhe llogaridhënese, e ndërtuar nga shoqëri të lira, ndarë mes aleatësh dhe vënë në shërbim të qytetarëve.

Përgjigjia përkundrejt përdorimit të automatizimit si armë nuk është dorëzimi teknologjik, është kapaciteti demokratik, është aftësia sovrane, është një inteligjencë e mirë artificiale në duart e atyre që mbeten llogaridhënës përkundër legjislacionit. Një inteligjencë sovrane artificiale nuk do të thotë izolim, do të thotë që asnjë vend të mos jetë i pafuqishëm përpara sistemeve që nuk mund të kuptojë, të kontrollojë apo t'i pranojë pa i sfiduar ato. Çdo vend duhet të jetë i aftë të mbrojë gjuhën e vet, komunikimet autentike, të autentifikojë komunikimet publike, të zbulojë manipulimet e koordinuara, të ruajë të dhënat e të informojë qytetarët e vet pa u varur krejtësisht nga përparësitë tregtare të një korporate të largët.

Ja pse Shqipëria, në shkallën e vet mikroskopike përkundrejt kësaj sfide gjigante, po ndërton një pasqyrë digjitale mbështetur mbi inteligjencën artificiale. Pasqyra do të identifikojë manipulimin në kohë reale, do të testojë pretendimet, krahasuar me informacionin e autorizuar, do të zbulojë strukturat e koordinuara, jo vetëm ato çfarë shihen, por edhe si e pse ka mbërritur tek ta. Nuk do t'u thotë qytetarëve se çfarë duhet të mendojnë. E drejta nuk mund të dekretohet nga asnjë qeveri. Duhet të jetë e mbështetur në të dhëna. Të nxirret nga burimet e duhura, të testohet, të sfidohet dhe të mbrohet haptazi. Pasqyra jonë nuk synon të shndërrohet në arbitër opinioni. Ka për synim të shndërrohet në një infrastrukturë transparence. Nuk kërkon të krijojë një ministri të së vërtetës, largqoftë, por kërkon të mbrojë shoqërinë kundër një industrie gënjeshtresh. Për rrjedhojë, Shqipëria bën thirrje për një marrëveshje ndërkombëtare për një inteligjencë artificiale sovrane e demokratike.

Së pari, qytetarët duhet të dinë kur përmbajtja politike me ndikim është gjeneruar artificialisht apo është manipuluar në përmbajtjen e saj.

Së dyti, arkitektura e shpërndarjes duhet të bëhet transparente. Qytetarët dhe shtetet duhet të kenë mundësi të dinë kush e krijoj, financoi, kush e shënjestroi apo amplifikoi artificialisht përmbajtjen politike me ndikim.

Së treti, çdo përdorim me ndikim i inteligjencës artificiale nga një institucion publik duhet të ruajë një zinxhir të qartë llogaridhënieje njerëzore ligjore.

Së katërti, demokracitë duhet të krijojnë një sistem të përbashkët paralajmërimi të hershëm në mënyrë që të dhënat e manipulimit të drejtuar nga Inteligjenca Artificiale të mund të rrugëtojnë midis të gjitha vendeve me mendësi të njëjtë po aq shpejt sa dhe vetë manipulimi. Si vende më të vogla e gjuhë të vogla, nuk duhet të braktisen jashtë kësaj "arkitekture" mbrojtëse. Sovraniteti digjital nuk mund të jetë një privilegj edhe njëherë rezervuar për shtetet më të pasura.

Gënjeshtrat "udhëtojnë" pa viza. Gënjeshtrat nuk duan t'ia dinë për mure, për kontrolle kufiri. Algoritmet i kapërcejnë kufijtë pa pasur nevojë për ndonjë pasaportë e pa frikën e ndonjë lloj qeverie. Ata që sulmojnë vendet tona bashkëpunojnë tashmë përtëj juridiksioneve. Vendet tona, demokracitë tona së pari e mbi të gjitha, duhet të mësojnë të bëjnë të njëjtën gjë. Kjo nuk është në fund të fundit një garë midis njerëzimit dhe makinave, është një garë midis qëllimeve të ndryshme njerëzore, secili prej të cilave amplifikohet nga makinat; midis atyre që përdorin Inteligjencën Artificiale për të ndriçuar dhe atyre që e përdorin për të mbjellë terr; midis atyre që e përdorin për të fuqizuar njerëzit, qytetarët e tyre dhe atyre që e përdorin për t'i manipuluar ata, midis atyre që pranojnë përgjegjësi dhe atyre që fshihen pas automatizimit. Nuk duhet të trembeni që makinat do të bëhen më njerëzore. Duhet të kemi frikë që qeniet njerëzore të mos bëhen të padukshme pas makinave.

Të dashur miq, çdo brezi i bëhet thirrje të mbrojë lirinë në një territor ku liria është nën kërcënim. Për një brez territori ishte fushëbeteja, për një tjetër ishte kutia e votimit. Për tonin është shumë i qartë, është mendja njerëzore. Le të sigurohemi që asnjë qytetar të mos lihet i vetëm përballë një ushtrie gjithmonë e më tmerruese algoritmike, le të sigurohemi që asnjë komb i vogël të mos detyrohet të huazojë kuptimin e realitetit nga jashtë kufijve të vet. Le të sigurohemi që asnjë demokraci të mos zgjohet pa asnjë palë zgjedhjeje për të zbuluar se qytetarët e vetë kanë ushtruar lirinë e tyre të zgjedhjes brenda një bote të projektuar në mënyrë të fshehtë për ta nga dikush që as nuk mund ta shohin e as nuk e dinë që është fuqia pas zgjedhjes së tyre. Inteligjenca artificiale nuk do të vendosë nëse ky shekull i përket lirisë apo manipulimit. Ne do ta vendosim. Makina do të bindet. Pyetja është kujt do t'i bindet? Sipas cilit ligj dhe në shërbim të cilit qëllim njerëzor.

Shqipëria e ka bërë zgjedhjen e vetë modeste. Ne kemi zgjedhur përshtetimin, jo dorëzimin. Kemi zgjedhur inovacionin, jo abdikimin. Kemi zgjedhur rritjen e jo atrofizimin e aftësisë njerëzore. Kemi zgjedhur lirinë e shprehjes. E dimë ç'do të thotë të jetosh pa të. E pikërisht sepse e kemi zgjedhur, refuzojmë ta ngatërrojmë me lirinë e pakontrolluar të makinave, parave dhe fuqive të huaja për të mbërritur te gjithkush gjithkund pa asnjë llogari. Ne zgjedhim të vërtetën jo sepse e vërteta është gjithmonë e lehtë apo e rehatshme, por sepse pa një angazhim të përbashkët ndaj realitetit nuk mund të kemi një jetë të përbashkët publike. E pa këtë angazhim prej të gjithëve ne ndaj realitetit të botës ku jetojmë do të jemi të angazhuar. Do të përfshihemi në tradhtinë më të tmerrshme që prindërit e kësaj bote në historinë e njerëzimit do të kenë bërë kundrejt fëmijëve të tyre. E pa një botë të përbashkët nuk mund të ketë Kombet e Bashkuara. Këtu përfundon predikimi im në shkretëtirë dhe shpresa që kam që është në fakt vendi i fundit ku mbështetem. Faleminderit!

ETIKETA EDITORAMA OKB

MË SHUMË NGA FORUMI

Sandër Simoni dhe Fatri
Islamaj, dy emra që i japin vlerë
Këshillit t...

Ish-shefja e SHISH nuk
shantazhoi median, por
kërcënoi armiqtë e saj!

Hetoni krimin, mos ua ktheni
jetën private në dënim publik!

Rikthimi i SHISH-it në politikë si
banalitet

Bledi Mane: Ergys Agasi, që na
shk*rdheu të gjithëve

O Zot, janë vërtet kaq
budallenj?

LAJMET E FUNDIT



Fjalimi i plotë nga kryeministri
Edi Rama në OKB

[48 SEKONDA MË PARË](#)

Komisioni European për
arrestimin e Vlora Hysenit:
Besim te SPAK, ndjekim nga
afër zhvillimet

[1 MINUTË MË PARË](#)

Inteligjenca Artificiale dhe
demokracia, Rama: Ne e
vendosim nëse shekulli do t'i
përkasë lirisë apo manipulimit

[20 MINUTA MË PARË](#)

Apeli nga Rama në OKB:
Shqipëria kërkon marrëveshje
ndërkombëtare, për një
Inteligjencë Artificiale sovrane
dhe demok...

[34 MINUTA MË PARË](#)

Plotësohen të gjitha vakancat
në KLGJ, zgjidhet edhe
Brunilda Kadi

[39 MINUTA MË PARË](#)

118 ditë protestë, Arben Kola:
Pensionistët vuajnë, kurse
Rama fle në dhomë me 15 mijë
dollarë nata

[48 MINUTA MË PARË](#)

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.